



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 56/16

Prishtinë, më 11.5.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Safet Hogja – Kryetar KRPP-së, Blerim Dina– Kryetar i OSHP-së, Agim Shaqiri – nga OSHP, Adnan Merovci-Kryetar i KPM-së, Naile Krasniqi-Kryeshefe e KPM-së, Arben Bilalli nga KPM, Musa Shabani – Kryesues i KPMM-së, Azem Rexhaj, Kemajl Zeqiri dhe Haradin Gërvalla nga KPMM, Ramiz Krasniqi- Drejtori i KPMM-së, Bedri Mecini- Drejtori i AKK-së, Dafina Hasanmetaj-nga AKK.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Fjolla Uka – monitoruese nga KDI, Sanije Berisha nga OSCE, Petrit Balaj dhe Ali Krasniqi nga Shoqata e Bankave, Albulena Mauraj- Gazetare nga Epoka e Re, Florina Ejupi- monitoruese nga BIRN.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2015;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavaur për Media vitin 2015;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2015;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – theksoi se ne mbledhjen e djeshme e kemi shqyrtuar në parim Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Meqë kemi të bëjë me një projektligj që kërkohet të miratohet me procedurë të përsheptuar, kërkojë që si komisioni ti propozojmë Kuvendit shamngja nga Rregullorja e Punës, për shqyrtimin e parë dhe të dytë të projektligjit.

Në bazë të propozimit të kryetari, Komisioni njëzëri nxori këtë

Propozim-Vendim

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, bëhet në seancën plenare më 18 maj 2016.
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe Komisionet e përhershme, duhet të përfundojë jo me vonë se më 23 maj 2016.
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, bëhet në seancën plenare jo më vonë se më 25 maj 2016.

2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015

Kryetari – theksoi se në bazë të nenit 87, paragrafi 2.13, të Ligjit për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, ka dorëzuar në Kuvend Raportin vjetor ku përfshin aktivitetet e Prokurimit Publik për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2015. Buxheti i KRPP-së për vitin 2015 ishte 913,303 euro, buxheti me rishikim 920,693 euro, ndërsa buxheti përfundimtar për vitin 2015 ishte 581,101 euro. Shpenzimet për vitin 2015 kane qene 581,101 euro ose shprehur në përqindje prej 100% e buxhetit përfundimtar duke mos përfshirë financimin e projektit të Bankës Botërore dhe Huamarrjes për E-prokurim.

Safet Hoxha – theksoi se gjithsej 10,895 kontrata publike. Prej këtyre 8,676 kontrata janë kontrata qeveritare, 2,194 të kompanive publike dhe 25 janë OJQ-ve. Sa i përket vlerës monetare, janë rreth 401 milion euro, duke përfshirë edhe vlerën prej 114 miljone për autostraden. Prej tyre 250,256,843 milion euro ose 62% e vlerës së kontratave janë kontrata të institucione qeveritare, 149,816,528 euro apo 37% janë kontrata të ndërmarrjeve publike dhe 0,44% janë OJQ-ve apo 1,770,253 euro. Në aspektin e pjesmarrësve, 62% e vlerës së kontratave janë qeveritare, ndërsa 37% janë të kompanive publike. Sa i përket mënyrës së burimeve të financimit, 147,482,411 euro apo 36.71% janë nga të hyrat vetanake, 251 milion euro apo 62.47% janë financuar prej buxhetit të Kosovës, donacione kemi prej 3,314,617 euro. Kemi një ngritje të të hyrave vetanake prej 20 milion dhe një ngritje të donacioneve prej 2 milion euro. Vlera e kontratave të nënshkruar sipas llojit të procedurave të prokurimit publik, në furnizim kemi 189,591,969 euro apo 47%, për shërbimet 57,189,990 euro apo 14.23%. Sa i përket vlerës së kontratave, kontratat me vlerë të mëdha janë 227,200,294 euro apo 56% të aktiviteteve të prokurimit, me vlerë të mesme kemi 151,551,828 euro apo 37%, me vlera të vogël 55%. Vlera e kontratave sipas procedurave të prokurimit, me procedurë të hapur kemi 306,798,669 euro, me procedurë të kufizuar

7,438,530 euro, konkurs projektimi 551,566 euro, të negociuar pas publikimit te njoftimit te kontratës 40,169 euro, të negociuar pa publikim te njoftimit te kontratës 64,695,068 euro, Kuotimi i çmimeve 20,108,584 euro, Procedurë për vlerën minimale 2,211,036 euro. Sa i përket vlerës së kontratave, por del se 99% janë kontata bazike, ndërsa 0,32 % jan aneks kontrata dhe kemi pas një ulje të mirë në përqindje të aneks kontratave prej 0,82%. Sa i përket kontratave sipas operatorëve që kanë marrë kontrata, 76% të aktiviteve janë të operatorëve ekonomik vendor, ndërsa jovendor 24% dhe kjo lidhet edhe me autostraden Prishtinë-Han të i Elezit. Në vitin 2015 kemi ngritje në pjesmarrje të operatorëve ekonomik dhe 5.8 kompani kanë ofertuar për një aktivitet të prokurimit publik. Raporti përmban edhe numrin e kontratave të nënshkuara nga aktiviteti kontraktuese të të gjitha aktiviteve dhe numrin e tyre për autoritetet buxhetore. Sa i përkat akvitviteve të KRPP-së, kemi katër departamente, përfshirë atë të monitorimit. Webfaqja është mjaft e vizituar dhe i ka 10,300 vizitor brenda ditës ka 16,400 shfletime, shkarkime ka 4,400. Kemi nxjerr 4 udhëzime administrative. Një punë e madhe është bërë në propozimet e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit qe ka ndryshuar mënyrën e prokurimit ne Kosovë. Me projektin e Bankës Botërore kemi krijuar një listë të çmimeve referente. Kemi bërë interpretime për autoritetet kontraktuese. Kemi filluar me prokurimin elektronik, përmes fazës së pilotimit. Sa i përket raportit të buxhetit , kemi pas një total prej 913,000 euro, 237,000 euro kanë qenë për paga e meditje të planifikume, ndërsa janë realizuar 220,000 euro, mallra e shërbime janë realizu 67,000 euro, shpenzime komunale 2,481 euro. Me buxhetin aktual do të jetë vështirë të mbahet platforma elektronike, sepse kërkohen ekspert të IT-së, tajnime shtesë dhe kërkohet mbështetje.

Kryetari – theksoi se raporti financiar përmban të dhëna të paskata dhe të paharmonizuara. Duke pasur parasysh faktin se ky është një dokument zyrtar, kërkohet që raporti të përmirësohet para se të procedojmë për Kuvend.

Besa Gaxherri – lidhur me raportin financiar, e përmendi edhe kryetari nuk është hartuar mirë, mungojnë të dhënat e sakta të sistemuara dhe duhet ta sjellni raportin e korigjuar se kështu nuk mund të procedojmë në seancë. Lidhur me raportin vjetor të punes, janë evidentuar 170 autoritete kontraktuese dhe janë nënshkruar 10,895 kontrata, dhe për një ofertë është arritur të ketë 5 apo 6 ofertues dhe kjo është mirë. Ne e kemi nje listë prej 17 autoritete kontraktuese, në kuadër të këtyre ju i keni 4 kontrata të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dhe procedurë të kufizuar është edhe kontratat në Radoniq të Gjakovës, Telekom i Kosovës, KEK-u dhe duke pasur parasysh se keni departamentin e monitorimit ju lutem na tregoni pse janë nënshkruar këto kontrata me procedurë të kufizuar dhe pse mos t'iu ipet mundësia kujdo me shpall ofertën? Në bazë të këtij dokumenti kemi parë se 1835 kontrata janë anuluar, ju keni bërë monitorim në disa ndërmarrje dhe është dashur të thuhet se cila organizata kanë bërë shkelje. E theksuat se përqindje e ofertuesve vendor karshi atyre ndërkombetar është e kënaqshme,por duke pas parasysh prokurimin prej 2007 e deri me tash, a keni mundur të nxjerrni analiza të statistikave në bazë monitorimit se sa përqind e kontraktuesve e fitojnë tenderin e njëjtë? Me prokurimin elektronik kryesisht jeni të kënaqur dhe do të jemi këtu me ju ndihmu sa te ka nevojë.

Safet Hoxha - perdorimi i procedurës se negociuar, te telekomi, KEK-u, ligji ka paraparë që procedimi i kësaj procedure është ekskluzivitet i autoritetit kontraktues.

Besa Gaxherri – kontrata në Radoniq të Gjakovës për ekzekutimin e përpunimit të dytë të ujit të pijes në shumë prej 6 milion 291 mijë euro, kontrata e Ministrisë së Arsimit prej 7,5 milion euro, për blerjen e librave, pse është dashur me u zhvillue me procedurë të kufizuar?

Safet Hoxha – sa i përket kontratës së Ministrisë së Arsimit, që ka të bëjë me blerjen e librave, lidhet me ekskluzivitetin ligjor në të drejtën autoriale. Te Radoniqi është me sistem me dy faza e ujit është me parakualifikim të cilin e ka marr sistemin e ujësjellsit në Prishtinë nuk ka qenë produrë e negociuar por procedurë e hapun dhe nuk ka shum telashe, ndërsa sa i përket pyejtes sa kompani të njëjta marrin

tenderë, prej nje analize qe ne nuk kemi arrit me finanlizu, del se kompanitë qe nuk marrin pjesë në tender në Kosovës janë ekonomikisht më stabile se ato që marrin pjesë.

Bardhyl Meta - unë e kam një qështje lidhur me tenderin e shpallur nga AQP me titull “shërbimet e pastrimit”, që është ndarë në 11 pjesë apo lloje ku është përcaktuar se një kompani mund të fitoj 3 lloje, pavarësisht a i plotëson kriteret apo jo apo e ka çmimin më të ulët se kompanitë tjera. Me këtë logjik një operatori oferton për 11 lloje për një çmim prej 10,000 euro, i fiton tri llojet e para me lëmimin e ofruar prej 3,000 euro, e llojet e dytë e fiton një kompani që ka ofertuar 20,000 euro apo 30,000 euro që është një humbje edhe për buxhetin e Kosovës. Pyetja ime është a ka KRPP rregulla të veçanta apo akte të caktuara nënligjore qe e rregullojnë këtë ndarje të llojeve, sepse per mua skenari i ri i përshtatet rregullave të reja të prokurimit për korrupsion?!

Safet Hoxha - sqaroi se ligji i prokurimit parasheh mundësinë që aktivitetet e prokurimit mund të ndahen në lloje homogjene dhe heterogjene. Ajo që ngritët ju ka të bëjë me ndarjen në lloje homogjene dhe ideja e ndarjes në këtë formë është që t’iu jepet mundësia më shumë kompanive për shkak të aspektit social që të ofertojnë më shumë në aktivitetet e prokurimit. Pra është një kriter qe buron nga direktivat e BE-së që pretendon me iu ndihmu bizneseve të vogla e të mesme.

Kryetari – propozoj që komision të përkrah raportin vjetor të punës dhe KRPP të sjille raportin financiar të korigjuar dhe pas vlerësimit të tij të procedojmë në Kuvend rekomandimin e komisionit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni përkrah Raportin vjetor të punës Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015.
- II. Kërkohe nga KRPP të dërgojë raportin vjetor financiar të përmirësuar, me të dhënat të saktat dhe të harmonizuara sipas formularëve standard të raportimit financiar në Kuvend.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2015

Kryetari - OSHP në pajtim me Ligjin për prokurimin publik i ka dërguar Kuvendit raportin vjetor dhe financiare të punës për vitin 2015, ku janë paraqitur të dhënat për aktivitetet e këtij organi që kërkohet me ligj.

Blerim Dina – theksoi se OSHP gjatë viti 2015 ka pranur gjithsejt 592 ankesa. Lëndët të cilat janë shqyrtuar janë 567, kurse 25 ankesa kanë mbetur pa u shqyrtuar pasi që nuk ka pasur bord. Aprovimi i ankesave ka qenë 166 nga këto 196 janë kryer me rivlersim, ndërsa me 129 OSHP-ja ka anuluar aktivitetet e Prokurimit dhe është bërë ritenderimi, pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore. Kanë qenë 53 operator ekonomik që i kanë terheq ankesat e tyre, kurse për shkak të jokompetencës të OSHP-së janë refuzuar 6 ankesa. Janë lëshuar gjithsej tri urdhëresa, kurse qështje të gjykuara kanë qenë 4 gjithsejt. Kemi trashiguar 74 ankesa te pazgjydhura qe ju ka kalu afati ligjore.

Safete Hadergjonaj - ajo që më bënë përshtypje që më së shumti ankesat që janë bërë në drejtim te procedurave të prokurimit janë për Komunën e Prishtinës, KEK-un dhe Ministrinë e Shëndetsisë, a keni ndonjë informatë pse kanë ndodhur të gjitha këto ankesa sepse në rivlerësim? Ne e dijmë se je rishtazi ne këtë punë, por a keni mundur me e pas informata qka ka ndodhur kështu, ku janë problemet e mëdha me procedurat e tenderimit në këto autoritete. Qështja tjetër ka të bëjë me raportin financiar, që është me shumë gabime, në prezantimin e shifrave dhe në përqindje dhe duhet të jetë një përgjegjësi ndaj

zyrtarit financiar. Për një ekonomist kur i sheh këto shifra është pak e dhimbshme. Një pyetje tjetër qka keni planifikuar qe ky proces me qenë transparent në të ardhmen?

Blerim Dina – në pyetjen e parë se disa autoritete kanë më shumë ankesa e disa me pak, nuk kemi bërë ndonjë analizë për ti gjet shkaqet. Por disa autoritete kanë buxhet më shumë dhe kanë procedura të tenderimit më të shumta.

Besa Gaxherri - nuk e jemi për me ju gjykuar, por nuk guxojmë me ju lëshu kështu me gabime. Ju jeni një organ shumë kredibil dhe për prokurimin keni kujdes se çdo fjali në raport ne duam arsyetim shtesë. Sa i përket aspektit buxhetor ska koment për nga mënyra se si i keni paraqitur të dhënat dhe sigurisht që kërkohet një raport i ri me përmirësimet e nevojshme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni përkrahu Raportin vjetor të punës Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015.
- II. Kërkohet nga OSHP të dërgojë raportin vjetor financiar të përmirësuar me të dhënat të saktat dhe të harmonizuara sipas formularëve standard të raportimit financiar në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavaur për Media vitin 2015

Kryetari - Komisioni i Pavarur i Mediave në pajtim me ligjin ka dërgua raportin vjetor në Kuvend. Raporti vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2015, pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar dhe shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike për vitin 2015, si dhe të dhëna për vitin 2014.

Adnan Merovci – foli për aktivitetet dhe vështrësitë që është ballafaquar KPM në vitin 2015. Si dhe për nevojat për buxhet shtesë për këtë vit. Në mënyrë të përmbledhur prezantoi buxhetin e shpenzuar.

Safete Hadergjonaj - sa i përket buxhetit të shpezuar për mallra dhe shërbime nuk ka shans teorike që me u shpenzue 100% apo me cent. Edhe tek ky institucion i kemi të njëjtat probleme sa i përket paraqitjes së shifrave dhe përqindjes në raportin financiar, ku janë paraqitur 100%. Krahasimet e shpenzimeve do të duhej të bëheshin me buxhetin përfundimtar. Çdo shkurtim që ka ndodhur me rishikim po vendim të qeverisë do të duhej të jepeshin sqarimet. Nuk ka mundur me u shpenzuar me cent. Nëse e marrim e shikojmë këto shifra kështu ne vijm në përfundim se keto shifra apo përqindje i keni qit përmendesh, unë kerkoj të përmirsohet ky raport financiar se nuk shkon kjo në seancë.

Kryetari – raporti duhet të përmbaj të dhëna të sakta, dhe këto që i keni prezantuar raporte duhen te jen te sakta por me shumë po e vlersojë si gabim teknik.

Arben Bilalli - shkurtimet e fundit janë bërë me 10 dhjetor 2015 nga qeveria dhe për këtë shpenzimet komunale janë 100%. Por kanë mbetur faturat e dhjetorit që janë duke u paguar në këtë vit. Auditori i Përgjithshëm na ka bërë vërejtje që në raport mos të paraqiten shkurtimet e qeverisë, prandja edhe jemi detyruar me ndrrue raportin.

Kryetari - problemet janë tek mallrat dhe shërimet dhe investimet kapitale, kur ti krahasosh shumat e buxhetit përfundimtar me shpenzimet, përqindja nuk del 100%. Prandaj duhet të korigjohen përqindjet dhe të sjellni raportin e korigjuar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Komisioni i Pavaur për Media të dërgojë raportin vjetor financiar të përmirësuar për vitin 2015, dhe më pas Komisioni do të nxjerr rekomandimin për Kuvendin.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015

Kreytari – KPMM ka raportuar në Kuvend në pajtim me ligji. Në vitin 2015 i janë ndarë 1,275,817€ nga buxheti i Kosovës, kurse buxheti përfundimtar ka qenë në shumë prej 1,186,273€, ndërsa buxheti i shpenzuar 1,129,638€, apo 95.2%.

Musa Shabani - shkurtimisht prezantoi aktivitetet e KPMM-së, sfidat që është ballafaquar ky komision dhe planet për të ardhmen.

Azem Rexha - KMPP buxhetin fillestare e ka pas të aprovuar në shume prej 1,275,873 euro, ndërsa buxhetin përfundimtar 1,186,273 euro. Gjithsej për paga dhe mëditje janë shpenzuar 100%, pasi që në muajin qershor me rishiqim buxhetor në vijën buxhetore në paga e meditje janë hequr 70,000 euro dhe pas diskutimeve me ministrinë e financave na është ndarë shuma e saktë e mjeteve në këtë kategori. Mallrat e shërbimet janë 86,9%, shërbime komunale 89.1%, subvencionet 100% , investimet kapitale janë shpenzuar 99,3%. Nëse e bëjmë krahasimin e buxheti viti 2014 -2015, KPMM ka arrit te kursej ne secilen vit buxhetore, me përjashtim për shpenzimet për derivate, mbushje telefonike e shpenzimet e qerasë. Të hyrat janë rritur për 11% krahasuar me 2014. Më pas foli për borxhet e krijuar nga operatorët që monitorojnë dhe borxhet e vjetra të papaguara. Sa i përket operatorëve ilegal janë 73 operues ndaj të cilëve janë bërë kallzimet penale.

Besa Gaxherri – lidhur me operatorët ilegal a e keni bërë ju listën apo ka qytetar apo grupe që janë ankuar dhe pastaj ju keni vepruar? Kjo për faktin se ka raste kur grup qytetarësh kanë ardhur dhe janë ankuar tek ju dhe nuk i keni marrë parasysh dhe kanë shkuar vetë në prokurori me ba kallzimin penal. Sa i përket shpenzimeve të telefoninsë mobile prej 19,215 euro janë të larta, dhe më intereson sa janë të lejuara mbushje në vit dhe sa persona i shfrytëzojnë ato?

Safete Hadergjonaj – në raportin financiar janë të prezantuara gjitha shënimet në menyrë të detalizuar, po qka po më bënë përshtypje hargjimi i mjeteve tek pagat e meditje 100%, pak po len dilema dhe kisha kerkue një shpjegim dhe me e pa listën e pagave të të punësuarve dhe si ka ardhur deri tek ky barazim? Sa i përket deytrimeve apo borxheve, listat ekzistojnë prej se jam deputete, dhe këto lista veç sa janë shtuar, që nuk është në rregull një gjë e tillë, ju lutem të na spjegoni pak më shumë këtë problematik?

Bardhyl Meta - lidhur me investime te huaja a ka ndonjë plan operativ që do tp kishte të bënte me prezantimin e pasurive për investitorët. A janë mbajtur ndonjë takim për këtë punë nga ana institucionit tuaj?

Azem Rexha – sa i përket kallzimeve penale në bazë të procedurave që ka KPMM, nëse del se nje qytetare na njofton qe ka operim ilegal, del inspektoriat dhe i banë matjet per operim ilegal dhe raportin e dërgon në prokurori. Secili kallzim penal e ka një raport të bashkangjitur. Sa i përket

telefonisë shumica ka të bëjë me stafin që del në terren. Sa i përket shpenzimeve për paga dhe mëditje, siq e thashk fillimisht me rishikim na janë shkurtuar mjetet, dhe më pas me një marrëveshje ministria e financave na ka alokuar mjete të sakta për nevojat për stafin aktual. Lista e detyrimeve për të gjitha operimet ilegale lëndët janë në prokurori. Nëse kompanitë nuk e shlyejnë obligimin KPMM nuk guxon me e heq nga lista e detyrimeve. Lidhur me atë se qfarë ka bërë KPMM me ndryshue klimën për investor, kemi pasur takime me ministrinë e zhvillimit ekonomik dhe minisitrinë e trgtisë dhe industrisë dhe jan zhilluar temat dhe problemet që shfaqen për investitorë, i kemi identifikuar edhe mospërorthjet me ligjin në këtë drejtim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2015

Kryetari- Agjencia ka raportuar në pajtim me ligji. Për vitin 2015, Agjencisë i janë ndarë 503,074 euro, me rishikim të buxheti, ka pasur një zvogëlim të buxhetit prej 46,970 euro, dhe buxheti përfundimtar ka qenë në shumë prej 474,014.43 euro dhe ky ndryshim përfshin kompensimin e përvojës së punës sipas vendimit të Qeverisë. Agjencia ka shpenzuar 453,079.07 euro apo 99.2 % të buxhetit përfundimtar.

Bedir Mecini - buxheti fillimisht ka qenë i aprovuara 573,714.99 euro, një pjesë e madhe u nda për shkak të projektit të bankës botërore prej 70,000 euro. 500,300.74 euro ka qenë buxheti përfundimtar. Përpara e mëditje kane qenë 340,477 euro, mallra e shërbime 154,097 euro, komunal 8,500. Më pas me rishikim kemi pasur zvogëlim të buxhetit në mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Agjencia ka shpenzuar 453,079.07 euro apo 99.2 % të buxhetit përfundimtar. Për paga dhe mëditje 100% apo 34,766.97, mallra dhe shërbime 97% apo 121,514.46 dhe shpenzime komunale – 100% apo 2,733.

Besa Gaxherri – në bazë të të dhënave të prezantuara, shpenzimet nuk i keni bërë sipas planifikimit. Shpenzimet jashtë vednit i keni 37% ndërsa mëditjet janë të shfrytëzuara 81 %, si është kjo diskrapancë? Shpenzimet e telefonisë mobile 105 %, shërbimet kontraktuese tjera 106%, qfarë janë këto? furnizim për zyre 145%, furnizim per ushqim e pije e dreka zyrtare 119 %, akomodimi diku 76%, ndërkaq shpenzimet për informim publik janë 0%, kur është detyrë e juaja ta informoni më shumë publikun.

Bedir Mecini - drekat zyrtare ne kemi planifiku 6,000 euro dhe janë shpenzuar 380 euro më shumë. Kjo është bërë për shkak të aktiviteteve me të gjitha pikat e kontaktit të institucioneve dhe komunave që i kanë caktuar zyrtarët kontaktuese per dekalorim të pasurise dhe në takimet që kemi pasur kemi paguar ndonjë sendviç dhe pije. Shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet jashtë vendit janë prezantuar sipas nënkodeve.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomadohet Kuvendit të miratojë Raportin financiar vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015.

3. Shqyrtimi i Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryetari – projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Projektligji nr.05/L-050 për Kinematografinë dhe amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani